

AKTI I THEMELIMIT
PER KRIJIMIN E PERSONIT JURIDIK
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ECO SB” SH.P.K

Sot më date 11/04/2024

- Z. Bledar Lisha lindur më datë 13/02/1981, ne Kukes, mbajtes i dokumentit të identifikimit me numer personal I10213118N, me adrese: Rruga “Idriz Dollaku” Tirane;
- Z. Sajmir Hitaj lindur më datë 24/06/1987 në Gjirokastër mbajtës I dokumentit të identifikimit më nr personal I 70624096L me adrese “Kodra e Diellit “ndertesa 2 Tirane;

EMRI I SHOQERISE:

Emri i shoqerise eshte ECO SB Sh.P.K;

Emri i shkurtuar është ECO SB shpk

Vula e shoqërisë është ECO SB shpk

Stampa e identifikimit nje ndertese me shkimin ECO SB

SELIA E SHOQERISE:

Selia zyrtare e Shoqerise eshte me adresë në Durres: Zona kadastrale 8518, numer pasurie 11/12, Njësia Administrative nr 5 rruga “Turizmi” Plazh, Lagjia 13.
Veprimtaria e ECO S&B Sh.P.K do te shtrihet ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise, si dhe jashte saj.
Shoqeria mund te çele degë /apo dhe të transferoje brenda ose jashte territorit të Shqipërisë .

AFATI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE:

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj dhe vepron si person juridik me personalitet te plote per te vepruar per nje kohe të pacaktuar, pervec zgjatjes ose prishjes se saj me vendim te ortakeve .

OBJEKTI I VEPRIMTARISE:

ECO SB Sh.P.K ka si objekt kryerjen e te gjitha aktiviteteve qe nje kompani me pergjegjesi te kufizuar mund te kryeje ne perputhje me legjislacionin shqiptar, brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise, perfshire por pa u kufizuar ne:
ndertim dhe shfrytëzimin e tokës dhe ujit duke promovuar rendesine e ujit dhe ruajtur diversitetin biologjik dhe minimalizuar ndikimet në ekosistemin ujqor për të ruajtur/promovuar zinxhirin ushqimor, ruajtjen e klimës dhe mjedisit, nëpërmjet studimeve, trajnimeve apo bashkëpunimeve me institucione, shoqata apo organizma të tjerë. Ndertimin dhe venien ne funksion te Impianteve per Trajtimin të Ujërave të

A

Ndotura.Pastrime llumi e inertesh e mbeturinash. Ndertimi i ndertesave kapanoneve, pusetave dhe impianteve. projektimin dhe zbatimin e projekteve ndertuese me materiale betoni druri apo materiale te cmontueshme. Instalimin e impianteve të trajtimit dhe largimit të ujërave të ndotur të të gjitha llojet e subjekteve, duke nisur nga strukturat akomoduese, agroturizmat, bujtinat, hotelet, komplekset turistike, baret, restorantet, dhe industrite e cdo lloji e cila lidh kontrate per kete sherbim. Trajtimin e ujrave nga tubacionet, kolektorët, pajisjet, ndërtesat dhe strukturat, që shërbejnë për mbledhjen e ujërave të ndotura, stacionet e pompimit etj. Trajtimin e ujrave lares nepermjet grumbullimit, transportimit, trajtimit dhe derdhjes në vendet e caktuara të ujërave të kanalizimeve. Vendosjen dhe kontrollin e pajisjeve dhe procedurave monitoruese për të siguruar funksionimin korrektt e ujrave, si dhe çdo përkufizim i vendosur për përmbajtjen kimike dhe bakterologjike të shkarkimit te ujrave. Vleresimin e Statusit kimik i ujërave tokesore dhe nëntokësoreqë shfrytëzojnë pasuritë ujore, natyrore dhe biologjike të burimeve ujore, Ri-përdorimi i ujit të trajtuar për vadije të ambienteve të gjelbra të komplekseve ose pastrim të territoreve. Përgatitja e programeve për parandalimin dhe shmangien e ndotjes së burimeve ujore pritëse nën juridiksionin e tyre, nga shkarkimet e lëngëta. Menaxhimi i ujërave të përdorura industriale nepermjet trajtimit te pjesshëm apo të plotë të tyre sipas karakteristikat e përcaktuara në akte ligjore ne fuqi. Trajtimin e kombinuar te ujrave me synim parandalimin e përkeqësimit, shtimin dhe kthimin në gjendje të pranueshme të trupave me ujëra sipërfaqësore. Promovimin e përdorimit racional e të qëndrueshëm të ujërave, i cili kryhet duke u bazuar në mbrojtjen afatgjatë të burimeve natyrore, Ndërmjetësim për lidhje kontratash midis agentëve tregtarë shqiptarë apo të huaj. Organizimi i trajnimeve dhe seminareve per mbrojtjen dhe zhvillimin e pyjeve, flores dhe faunes. Grumbullim materialesh me qellim riciklimi. Sherbime si ndertim te veprave industriale, turistike, civile, bujqesore dhe kompletim me instalimet e nevojshme per to. Studim e projektim në ndërtim; Mbikëqyrje e kolaudim punimesh zbatimi në ndërtim. Punime restaurimi,vepra beton/ beton armeje te vecanta. Punime dheu, murature, betony. Marrje me qira, në huapërdorje dhe shitje të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme për zhvillimin e veprimtarisë së Shoqërisë. Import – Export: detergjente industrial, makineri pastrimi, pompatë fuqive te ndryshme. Paisje per sisteme hidroponike substrakte te ndryshme, Paisje per sera ventilator, filtra uji,sisteme elektrike.ndricues me spektrum te plote.

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i nenshkruar i shoqerise ka nje vlere prej 400.000 (katerqind mije) leke.
Z. Bledar Lisha zoteron 1 (një) kuotë me 75 % te kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 300,000 (treqind mije) leke pjesë e kapitalit themeltar;
z. Sajmir Hitaj zoteron 1 (një) kuotë me 25 % te kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 100,000 (një qind mije) lekë pjese te kapitalit themeltar;

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepërmjet kontributeve të reja në para apo në natyre sipas vendimeve te asamblese të marra me shumicë të parashikuara për ndryshimet e ketij statusi.

ORGANET E SHOQERISE

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e Ortakeve dhe Organet administrative. Asambleja e ortakeve organizon, drejton dhe kontrollon gjithë aktivitetin e shoqërisë. Ai është organi vendimarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me statusin zgjedh dhe emeron administratorin. Ortaku/ortaket e shoqërisë përballojnë humbjen deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre. Organi administrativ i vetëm është administratori i shoqërisë. Për një periudhë 5-vjeçare nga data e regjistrimit të saj, shoqëria cakton si administrator të saj Z.Bledar Lisha, lindur më datë 13/02/1981, në Kukës, mbajtës i dokumentit të identifikimit me numer personal I 10213118N me adresë Rruga "Idriz Dollaku" Tirane. Administratori përveç sa është e përshkruar në ligj bazuar në objektin e veprimtarisë që ushtron shoqëria, zgjedh dhe emeron drejtuesin teknik dhe çdo ekspert me njohuri të posaçme profesionale që kërkohen për mbarvajtjen e aktivitetit kur është i nevojshëm sipas ligjit dhe veprimtarisë së shoqërisë.

BAZA LIGJORE

ECO SB Sh.P.K; e ushtron veprimtarinë e saj bazuar në ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar; Ligjin nr. 9115, datë 24.07.2003, "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura", i ndryshuar; b) Ligjin nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar; LIGJ Nr. 93/2015 "Për Turizmin"; Ligji Nr.10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" (i ndryshuar); Ligji Nr.9115, date 24.7.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura" (i ndryshuar); Ligji Nr. 9587, datë 20.7.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit" (i ndryshuar); Ligji Nr.10 440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" (i ndryshuar); ligj për planifikimin dhe zhvillimin e territorit). Direktiven e Parlamentit dhe Këshillit Evropian datë 15.02.2006 lidhur me menaxhimin e cilësisë së ujërave larës; g) Direktiven 86/278/KEE "Për lumenjtë e ujërave të ndotura"

DISPOZITA TE FUNDIT

Ndryshimet në Aktin e Themelimit mund të bëhen vetëm me shkrese dhe të miratuar nga asambleja e ortakeve. Pjesë e pandarë e këtij akti është statuti i shoqërisë i cili nënshkruhet rregullisht nga themeluesit e shoqërisë. Ky akt themelimi u hartua në Durrës në datë 03.04.2024, në 5 kopje origjinale, i cili nënshkruhet rregullisht konform ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar. Përmbajtja e këtij akti themelimi u lexua dhe nënshkrua nga ortaket themelues të shoqërisë duke autorizuar administratorin Z Bledar Lisha të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë qendrës kombëtare të regjistrimit QKB .

THEMELUES

Bledar Lisha


Sajmir HIRAJ
